



RREGULLORE PER FUNKSIONIMIN E PROGRAMIT

"QYTETI I ARTEVE"

KREU I ORGANET MENAXHUESE TE PROGRAMIT

Neni 1

Zyra Koordinuese e Eventeve ZKE dhe Bordi i Projekteve Artistike BPA

ZKE përbëhet nga tre punonjës të Rektoratit: një përgjegjës (i cili mund të jetë zv | rektori për projektet artistike), një përfaqësues i degës juridike dhe një përfaqësues i degës së financës ose Kancelari, të cilët do të menaxhojnë dhe monitorojnë aplikimet dhe implementimin e projekteve fituese.

Neni 2

Zgjedhja dhe emërimi i anëtarëve ZKE-së dhe përgjegjësit të zyrës, bëhet nga Rektori i Akademisë së Arteve.

Neni 3

ZKE vlerëson nëse projektet përputhen me kriteret e përshtatmërisë.

Neni 4

BPA përbëhet nga 5 anëtarë. Tre përfaqësues nga fakultetet dhe dy nga Rektori. Anëtarët e Bordit duhet të jenë pjesëtarë të personelit akademik me kohë të plotë të Akademisë së Arteve

Neni 5

Anëtarët e BPA-së përzgjidhen dhe emërohen nga Rektori.



Neni 6

BPA vlerëson dhe rradhit projektet fituese në bazë të kriterëve fituese të përcaktuara duke ruajtur një raport të drejtë midis fushave ku zhvillohet (Muzikë, Art Skenik, Art Pamor ose Interdisiplinor).

KREU II APLIKIMI, SHPALLJA E AFATEVE, PROJEKTET FITUESE

Neni 7

ZKE shpall afatet për aplikim për projektet artistike të programit Qyteti i Arteve.

Neni 8

Aplikantët dorëzojnë projektet e tyre në tre kopje origjinale dhe një kopje në formë elektronike pranë ZKE-së.

Neni 9

Kriteret e përshtatmërisë

1. Të kenë si synim kryesor një nga prioritetet e përcaktuara;
2. Të realizohen në publik dhe përballë audiencës së gjërë;
3. Aplikuesi duhet të kontribuojë në masën 20% (në cash ose kontribute të tjera);
4. Te respektoje normat ligjore dhe financiare në realizimin e projektit;

Neni 10

Mospërshtatshmëria e projekteve

Projektet artistike nuk duhet të jenë:

1. Botime shkencore dhe tekste mësimore;
2. Bursa studimi për brenda dhe jasht shtetit;
3. Kosto ndërtimi dhe mirëmbajtje infrastrukture;
4. Aktivitete ekskluzivisht komerciale;



5. Shpenzime për organizimin e procesit mësimor;
6. Shpenzime për provime dhe mbrojtje diplome të individëve;

Neni 11

Aplikanti dhe aplikimi

1. I njëjti aplikant nuk mund të përfitojë më shumë se një projekt në vit dhe më shumë se dy herë rrjesht;
2. Aplikanti nuk mund të jetë anëtar i Bordit të Projekteve Artistike dhe / ose pjestar i ZKE-së;
3. Të drejtën e aplikimit e kanë vetëm personeli akademik me kohë të plotë dhe studentët me kohë të plotë për të cilët (studentët) projekti duhet të përfundojë ndërkohë që janë në marrëdhënie me AA-në;
4. Aplikanti nuk mund të aplikojë në emër të institucioneve shtetërore (përveç AA-së) si dhe institucioneve private konkurruese që e shtrijnë aktivitetin e tyre në të njëjtën fushë me Akademinë e Arteve;
5. Aplikanti duhet të pranojë kushtet e grantit;
6. Financimi i projektit nuk mund të transferohet në vitin pasardhës;
7. Formulari i Aplikimit duhet të jetë e plotësuar në mënyrë korrekte dhe pa korrigjime sipas rubrikave të përcaktuara. Studentët duhet të shoqërojnë projektin edhe me rekomandime nga dy anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë pranë Akademisë së Arteve;

Neni 12

ZKE shqyrton projektet në bazë të Kritereve të Përshtatmërisë, objektivave dhe prioriteteve të shpallura në Program dhe i paraqet ato që i plotësojnë këto kushte në BPA, shoqëruar me komentimin përkatës.

Neni 13

BPA merr në shqyrtim projektet e paraqitura nga ZKE dhe i radhit fitues ose jo në bazë të Kritereve Fituese të përcaktuara me shumicën e votave të Bordit.

Neni 14

Kriteret Përzgjedhëse



1. **Cilësia Artistike:** Me qëllim të vlerësimit, cilësia artistike do të konsiderohet në termat e mëposhtëm:
 - a. Cilësitë dhe kapaciteti profesional i aplikuesit, pjesëmarrësve dhe partnerëve të tjerë;
 - b. Origjinaliteti;
 - c. Shtrirja;
 - d. Rezonanca në publik, opinionin artistik dhe joartistik si dhe në median e shkruar dhe audiovizive;

2. **Novacioni:** Projektet duhet të demonstronë Novacion në idetë dhe | ose në realizimin e tyre.

3. **Vizibiliteti:** Elementët më të rëndësishëm në këtë aspekt janë:
 - a. rritja e prezencës së AA-së në jetën kulturore të Kryeqytetit dhe më gjerë në mënyrë që të rritet interesi për bashkëpunim me Institucionin tonë;
 - b. bërja më prezente e Akademisë së Arteve përballë tregut të arsimit në fushën e Artit nëpërmjet aktiviteteve cilësore duke rritur në këtë mënyrë dëshirën për të studiuar artet;
 - c. publiciteti që realizohet me materialet propaganduese të këtyre aktiviteteve (postera, fletë-palosje etj.);
 - d. prezenca aktive në massmedia nëpërmjet konferencave për shtyp, kronikave etj.;
 - e. prodhimi i CD-ve, DVD-ve, Partiturave, Katalogëve etj. (kopje të të cilave duhet të dorëzohen pranë bibliotekës dhe fonotekës së AA-së);

4. **Promovimi:** Për plotësimin dhe vlerësimin e këtij kriteri është i rëndësishëm:
 - a. promovimi i vlerave më të spikatura të artit bashkëkohor dhe atij të traditës që zhvillohet nga stafi pedagogjik dhe studentët e Akademisë;
 - b. Promovimi kapaciteteve profesionale të personelit akademik dhe studentëve krijues dhe interpretues jo vetëm brenda por edhe jashtë vendit;

Neni 15

Mbledhja e BPA thirret nga ZKE bazuar në afatet e shpallura për aplikim. Bordi mbledhet jo më pak se dy herë në vit. Mbledhja quhet e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më



pak se 4 anëtarë të Bordit. Protokolli i mbledhjes mbahet nga një punonjës i AA-së i caktuar nga Rektori dhe firmoset në fund të mbledhjes nga të gjithë anëtarët e pranishëm të BPA-së.

Neni 16

Mbledhja e Bordit të Projekteve Artistike drejtohet nga një anëtar i BPA-së i emëruar nga Rektori i AA-së.

KREU III ORGANIZIMI DHE MENYRA E APLIKIMIT DHE FINANCIMIT TE PROJEKTEVE

Neni 17

Aplikantët duhet të plotësojnë Formularin e Aplikimit me korrektësi dhe pa korrigjime në respekt të të gjitha kriterëve të shpallura, duke shprehur qartë qëllimin dhe afatet e projektit.

Neni 18

Kontrata e financimit të projektit fitues nënshkruhet nga Aplikuesi dhe Rektori i Akademisë së Arteve ose një person i autorizuar prej tij.

Neni 19

ZKE dhe BPA kanë të drejtë të kthejnë mbrapsht për plotësime dhe/ose të shpallin jofitues projektet kur ato nuk plotësojnë Kriteret e shpallura.

Neni 20

Aplikantët fitues dhe jofitues lajmërohen nga ZKE brenda pesë ditë pune nga vendimi.

Neni 21

Aplikantët fitues kanë të drejtë financimi deri në 60% para fillimit të projektit. 40 % i mbetur paguhet gjatë ose në përfundim të projektit.

Neni 22

ZKE monitoron dhe vlerëson nëse projekti i përmbahet qëllimeve dhe shpenzimeve të shpallura. Nëse projekti i shkel ato, ZKE-së i lind e drejta të ndërpresë financimin e projektit dhe të kërkojë rimbursimin e fondeve të lëvruara deri në atë moment.



Neni 23

Rektori është i vetmi autoritet që mund të kthejë mbrapsht vendimet e ZKE-së dhe BPA-së

Neni 24

Aplikantët kanë detyrimin të dorëzojnë nje raport të detajuar në përfundim të projektit, shoqëruar me materjale dhe dokumentacionin përkatës siç janë posterat, fletë-palosje, fotografi nga aktiviteti ose cd dhe dvd, katalogë etj. si dhe kritika dhe kronika në mass-media nëse ka patur. Aplikantët kanë detyrimin të dorëzojnë pranë bibliotekës dhe fonotekës, materjale të botuara nga projekti (si cd, dvd, partitura, katalogë etj) nëse ato kërkohen nga ZKE para fillimit të realizimit të projektit.

Aplikantët kanë detyrimin që të vendosin logon e Akademisë së Arteve dhe titullin e Programit "Qyteti i Arteve" (si dhe eventualisht logon e këtij Programi), në të gjithë dokumentat, produktet apo materialet e krijuara apo prodhuara ne kuader te projektit te fituar dhe te financuar nga Programi "Qyteti i Arteve", si dhe të shprehin faktin e financimit të projektit nga ky Program.

Neni 25

1. Fituesit e projektit kanë detyrimin e raportimit financiar tek Akademia e Arteve. Raportimi përfshin Raportimin paraprak dhe Raportimin përfundimtar. Raporti paraprak financiar paraqitet nga përgjegjësit e projektit para marrjes së kështit të dytë të financimit të projektit prej 40%. Raporti Përfundimtar paraqitet në përfundim të projektit.
2. Raportimi financiar përfshin një përshkrim të shpenzimeve që janë kryer, në përputhje me buxhetin e miratuar me miratimin e projektit. Raportimit i bashkëngjiten edhe të gjithë dokumentat financiarë që vërtetojnë kryerjen e shpenzimeve përkatëse, si kontrata shërbimi me personat e angazhuar dhe që marrin pagesë, fatura blerje, etj të kësaj natyre. Dokumentat duhet të jenë origjinale.
3. Fituesit e projektit duhet të kenë parasysh përmbushjen e detyrimeve me karakter fiskal gjatë kryerjes së veprimeve financiare.



4. Mosdokumentimi i veprimeve financiare sjell mosmbulimin dhe heqjen e financimit për pjesën përkatëse të paargumentuar dhe të mbështetur me dokumentacion, të zërave të buxhetit.

Neni 26

Shpërblimi i anëtarëve të BPA-së dhe ZKE-së, bëhet në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 27

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë

Prof. Petrit MALAJ

**REKTOR
AKADEMIA E ARTEVE**